



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

Nr. 531 / Prot.

Vlorë më, 03.02. 2025

VENDIM

Nr. 3, datë 03.02. 2024

PËR

PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SË STUDENTËVE BURSISTË, TË
FINANCUARA PREJ SUBJEKTEVE TË TRETA

Në zbatim të nenit 3, pika 4, gërma c, nenit 40, nenit 109, pika 1, gërma ç,d, Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 19, pika, gërma rr), neni 31, pika 9, neni 86, pika 1, gërma ç), d), të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe në përgjigje të kërkesës së subjekteve të treta për akordimin e bursave për studentët e UV, Rektorati në mbledhjen e datës 28.01. 2025

VENDOSI:

Procedura e përzgjedhjes së studentëve që do të përfitojnë nga bursat e akorduara prej subjekteve të treta për studentët që ndjekin studimet në programet mësimore të Universitetit 'Ismail Qemali' të jetë si vijon:

1. *Propozimi për përzgjedhjen e studentëve bursistë.*

Pas marrjes së ofertës për akordimin e bursave prej subjekteve të treta për studentët e UV, Sektori i Karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumnëve, paraqet në Rektorat propozimin për përzgjedhjen e studentëve që do të përfitojnë bursat. Ky propozim përmban:

- a. Përcaktimin e Fakultetit ku do të jepen bursat
Ky përcaktim bëhet në bashkëpunim me subjektin e tretë, sipas fushave të interesit të tyre, të shprehura në mënyrë shkresore ose online.
- b. Vlerën e secilës bursë
Shuma e akorduar mund të jetë mujore apo vjetore, referuar bursave të ekselencës, që jepen me VKM nr. 39, datë 23.1.2019 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 903, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "për përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar.
- c. Afatin e bursës
Procedura rutinë është që bursa lidhet për një vit, me të drejtë rinovimi nëse studentët arrijnë:
 - o të ruajnë notën mesatare 9-10,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI**

- të jenë frekuentues në UV.
- Përfshihen nga kjo procedurë rutinë bëhen vetëm me kërkesë të palës së tretë, që financojnë bursën.
- d. Studentët që e përfitojnë bursën:
Studentë që ndjekin studime në çdo cikël studimi në fushat e studimit të parapërcaktuara, sipas dakortësimit me palën e tretë të shprehur në mënyrë shkresore ose online.
- e. Kriteret e përfitimit:
 - a. Kriteret akademike: mesatarja e vitit të mëparshëm të studimit ≥ 9.0 . Në mungesë të aplikantëve me këtë mesatare, mund të zbritet në mesatare më poshtë.
 - b. Studentë frekuentues.
 - c. Kriteret e nevojës sociale apo ekonomike: mund të shihet me avantazh një student i cili plotëson kriteret e mësipërme dhe vjen nga kategoritë në nevojë.
 - d. Vlerësimi i pjesëmarrjes në aktivitete studentore (Këshilla studentore, Gazeta apo Radio studentore), vullnetarizëm ose projekte kërkimore.Përfshihen nga këto kritere bëhen vetëm me kërkesë të palës së tretë, që financojnë bursën.

2. Procesi i aplikimit dhe përzgjedhjes:

- a. Procesi i Përfitimit të Bursës ndiqet prej Sektorit të karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumnit.
- b. Zëvendësrektori akademik përgatit Thirrjen për aplikim me Kriteret e Përfitimit, Formularin e Aplikimit dhe Tabelën e Pikëzimit për vlerësimin e aplikimeve:
 - mesatarja akademike e vitit paraardhës,
 - nevoja financiare (sipas argumentimit të dokumentuar të studentit),
 - angazhimi në aktivitetet studentore.
- c. Thirrja për aplikim bëhet publike në të gjitha faqet mediatike të UV dhe në vende të dukshme pranë Sekretarive Mësimore të fakulteteve të përfshira.
- d. Dorëzimi i Formularëve të Aplikimit bëhet pranë Zyrës së Studentëve, të cilat më pas i dorëzojnë tek Sektori i karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumnit. Ky sektor u kërkon kryesekretareve të fakulteteve përkatëse të verifikojnë mesataret dhe frekuentimin e studentëve aplikues.
- e. Sektori verifikon paraprakisht studentët që plotësojnë kriteret e përfitimit të bursave dhe skualifikon ata që nuk i përmbushin këto kritere, sipas dokumentave të ardhura nga kryesekretaret e fakulteteve përkatëse.
- f. Në nivel Rektorati ngrihet Komisioni *ad hoc* i Përzgjedhjes së Studentëve Bursistë, i përbërë nga 5 anëtarë nga kategoria Profesorë, me përbërje nga Profesori i fakulteteve të përfshira.
- g. Komisioni i Përzgjedhjes së Studentëve Bursistë, i thirrur prej Kryetarit të tij, vlerëson dosjet e dërguara prej Sektorit të karrierës, shërbimit të studentëve dhe alumnit për studentët që plotësojnë kriteret e përfitimit, sipas Tabelës së Pikëzimit për vlerësimin e aplikimeve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

- h. Lista e renditjes së studentëve përfitues të bursave bëhet publike në faqet mediatike të UV dhe në vende të dukshme pranë Sekretarive Mësimore të fakulteteve të përfshira.
- i. Ndaj këtij vendimi studentët kanë të drejtë të ankimojnë pranë Sekretarive mësimore përkatëse. Komisioni i Apelit prej 3 pedagogësh të kategorisë Profesor, i ngritur në nivel Rektorati, shqyrton ankesën dhe komunikon vendimin tek studentët ankimues. Vendimi i këtij komisioni është përfundimtar.

3. Lëvrimi i bursës:

- a. Lista e studentëve të përzgjedhur për përfitimin e bursave, sipas vendimit të komisionit i dërgohet për zbatim palës së tretë dhe Sektorit ekonomik të UV.
- b. Studenti përfitues i përzgjedhur do të lidhë një kontratë me përfaqësuesin e caktuar nga pala e tretë që financon bursën.
- c. Të ardhurat do të transferohen në llogarinë e studentit direkt prej palës së tretë (donatorëve).Sektori Ekonomik do të sigurohet prej Sektorit të kurrikulave dhe statistikave, që në kohën e lëvritit të bursës studentit është frekuentues, e më pas të procedojë dhe kalimin e bursës në llogari të studentit.

4. Studentët e humbasin ose nuk i rinovohet bursa në rast se:

- a. vazhdojnë studimet në një program të dytë studimi;
- b. shpallen ngelës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese;
- c. nuk kanë përfunduar programin e studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij, të përcaktuar në aktin e hapjes së programit përkatës të studimit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORE

Prof. Dr. AURELA SALIAJ

